



Pranuar / Dorezuar Priliceno/Prodato Received/Delivory	27.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtupis Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDRSHCK	8486/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.991/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.991/2022 të datës 10.11.2022 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës-transferim në rast të ristrukturimit", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.991/2022 e datës 10.11.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 10.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7007/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Raportit të Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër protokollit 1620 të datës 01.11.2022, për shkak të shkeljeve të ligjit material, shkeljeve thelbësore të procedurës dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses të Ministrisë e Punëve të Jashtme dhe

Diasporës. Ndërsa, Këshilli më datë 18.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollin 7007/2022 të datës 10.11.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga ankuesja; Akt Emërimit me Nr. Ref: 293/2014 të datës 21.0.2014 për ankuesen; Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.12/2022 të datës 10.05.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për transferimin e nëpunësit civil S.U; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 13.01.2021; Plotësimin e ankesës e datës 11.11.2022 me numër protokollin 7012/2022; Akt Emërimit e datës 10.09.2019 për ankuesen; Vendimin me numër 228-1/2005 i datës 29.06.2005; Kontratën e punës së datës 16.07.2007; Kontratë mbi kryerjen e punës së përkohshme me Nr. Prot: 07/67/47 i datës 06.11.2007; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.Prot: 332/2010 e datës 30.04.2010; Kontratën mbi kryerjen e punës së përkohshme me Nr.Port:631/2008 e datës 31.03.2008; Vendimin me numër 756/2008 i datës 30.04.2008; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.756/2008 e datës 30.04.2008; Kontratën mbi kryerjen e punës së përkohshme me Nr.Prot: 183/2007 e datës 28.12.2007; Certifikatë e marrëdhënies së punës me Nr. Prot: 672/2011 e datës 09.08.2011; Vendimin për avancim i datës 05.303.2012; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.Ref:094/2012 e datës 02.02.2012; Vendimin me numër protokollin 153 i datës 01.03.2012; Vendimin me Nr.Ref: 076/2012 i datës 25.01.2012; Vendimin për caktimin e ushtruesit të detyre me Nr.902/2013 i datës 20.09.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për Udhëheqës të Divizionit për Themelimin dhe Mbikëqyrën e Qendrave Kulturore në Diasporë dhe Udhëheqës i Divizionit për Integritet Evropian dhe i Koordinimit të Politikave; Vendimin me numër protokollin 652 të datës 02.05.2019; Vendimin për caktimin e ushtruesit të detyrës me numër protokollin 1723 i datës 22.11.2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollin 7107/2022 i datës 15.11.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokollin 7228/2022 e datës 18.11.2022; Formulari i vlerësimit të Komisionit të Ristrukturimit për pozitën Drejtor i Departamentit për Diasporë; Raportin të punës së Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër protokollin 1620 të datës 01.11.2022; Njoftim i datës 27.10.2022, 28.10.2022 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore MPJD; Vendimin me numër protokollin 304 i datës 24.02.2022 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Emailin e datës 11.03.2022 nga S.K për V.B; Njoftimin e datës 15.03.2022 për ankuesen nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër protokollin 20 i datës 16.03.2022 për miratimin e përshkrimit të detyrave të punës për pozitën e nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses me numër A. nr.991/2022 e datës 10.11.2022 është e parakohshme, **SEPSE**:

Nga vlerësimi i provave të lëndës rezulton se më Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e vendeve të punës.

Me tej, nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022 të Zëvendësueses së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë (tutje DMZP-ja) është themeluar Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në MPJD ka njoftuar individualisht ankuesen së në rastin konkret të ristrukturimit do të aplikohen dispozitat e nenit 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesja në bazë të Akt Emërimit me numër protokolli 1610 të datës 10.09.2019 ka qenë e emëruar në pozitën Drejtor i Departamentit për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporës në ish Ministrinë e Diasporës, ndërsa sipas Rregullores Nr. 01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kjo pozitë nuk është paraparë. Në bazë të provave të lëndës ankuesja ka shprehur interesin të sistemohet në pozitën Drejtor i Departamentit të Diasporës për të cilën pozitë përveç ankueses kanë shprehur interes dhe tre (3) nëpunës të tjerë. Komisioni i Ristrukturimit ka bërë vlerësimin e aplikacioneve të të gjithë të interesuarave dhe në bazë të formularit të vlerësimit ankuesja për nga vjetërsia në shërbimin civil ka marr 15 pikë, tek vlerësimet e rezultateve në punës është vlerësuar me 13 pikë, tek kualifikimet profesionale ka marr 20 pikë ndërsa tek trajnimet ka marr 11 pikë nga kjo del që gjithsejti ka marr 59 pikë duke u vlerësuar me më së paku pikë nga të gjithë kandidatët e interesuar. Pas këtij proces, Komisioni i Ristrukturimit për pozitën e punës me titull Drejtor i Departamentit të Diasporës ka rekomanduar që të emërohet kandidati S.Ukshini pasi që i njëjti është vlerësuar me gjithsejtë 86 pikë, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme konform këtij rekomandimi ka lëshuar Vendimin me Nr.12/2022 të datës 10.05.2022 lidhur me transferimin e nëpunësit civil të S.U në pozitën e punës Drejtor i Departamentit të Diasporës, ndërsa Komisioni i Ristrukturimit ka bërë propozim për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme që ankuesja të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Ankuesja e pa kënaqur me mos sistemin e saj në kuadër të MPJD-së, me datë 29.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli me Vendimin me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 ka kthyer çështjen në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj çështjen e ankueses.

Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke vepruar sipas vendimit të Këshillit me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, ka shqyrtuar çështjen e rastit të ankueses dhe në bazë të Raportit të veçantë të punës me numër protokolli 1620 të datës 01.11.2022, ka konstatuar se ankuesja nuk mund të sistemohet përkatësisht të transferohet në ndonjë pozitë të lirë brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak që nuk ka plotësuar kushtet e pozitave respektivisht kushtet e posaçme formale, duke propozuar që e njëjta të transferohet në pozitën Udhëheqës e Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Raporti i Punës së Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të

Jashtme dhe Diasporës me numër protokolli 1620 i datës 01.11.2022 është nxjerr në kundërshtime me legjislacionin në fuqi dhe Vendimin e Këshillit.

Në kuptim të pranshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 125 paragrafi 1, me të cilin është përcaktuar se: "Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")", Rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke qenë se ankuesja ka kundërshtuar Raportin e Komisionit të Ristrukturimit përkatësisht meqenëse nga Komisioni i ristrukturimit nuk është nxjerrë ndonjë akt administrativ lidhur me sistemin e ankueses për shkak të ristrukturimit, Kolegji vlerëson se në këtë fazë të procesit ankesa e ankueses është e palejuar gjegjësisht e parakohshme.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.991/2022

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

